



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI
VENDIM

Nr. 72, Datë 10.05.2019

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “SMART WATT” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2MW, NË ZONËN SHEQ MARINAS, NJËSIA ADMINISTRATIVE TOPOJË BASHKIA FIER.

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2 gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, neneve 4, pika 1, gërma “a”; neni 5, pika 1 gërma “a”; neni 10 pika 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, neni 15 i “Rregullave për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s,” Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 10.05.2019 mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi licencimin e shoqërisë “SMART WATT” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2MW, në zonën Sheq Marinas, njësi administrative Topojë, Bashkia Fier.

Konstatohet se:

- Bordi i ERE-s, me Vendimin nr. 50, datë 27.03.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “SMART WATT” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, për një afat 25 vjeçar.
- Shoqëria “SMART WATT” sh.p.k., është një subjekt përfaqësues në cilësinë e Mbajtësit të Miratimit Përfundimtar me nr. 5864/11, datë 14.11.2018. Kjo shoqëri është e regjistruar pranë QKB, në datën 20.11.2017, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k), konform Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit”, me numër identifikimi (NUIS) L72320013B.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.822, datë 07.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike”, që nuk janë objekt koncesioni, i ndryshuar. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë i jep të drejtën e Financimit, projektimit, ndërtimit, vënies në punë me kapacitet prodhues 2 MW.

- Objekt i veprimtarisë së “SMART WATT” sh.p.k është ndër të tjera edhe kryerja e aktivitetit të import, eksport, tregtim, dhe furnizim me shumicë dhe pakicë të energjisë elektrike si brenda dhe jashtë Shqipërisë. Ndërtimin e impjanteve të energjisë së rinovushme, prodhim të energjisë, studim dhe konsulencë në aktivitetin e energjisë elektrike. Kryerja e çdo aktiviteti të lejuar nga legjislacioni për shoqëritë tregtare.
- Aplikimi i bërë nga shoqëria “SMART WATT” sh.p.k, për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjise elektrike nga nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar 2 MW, plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
 - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Dokumentacioni teknik, për Centralet Solare (neni 9, pikat 4.4.1; 4.4.2, 4.4.3 gërmat “a”, “b”, “c” “d”; 4.4.4 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”; 4.5 gërma , “b”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Në lidhje me parashikimet e Nenit 9, pika 4.5, gërma “a” (miratimin e OST ose OSHEE-s, për lidhjen e centralit në rrjetin elektrik të transmetimit ose shpërndarjes), shoqëria ka aplikuar për marrjen e miratimit pranë OSHEE dhe kjo e fundit ka rekomanduar lidhjen në rrjetin e transmetimit.
 - Në nenin 27 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, ndryshuar, parashikohet se, Operatorët e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes duhet të sigurojnë lidhjen me rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes mbi kushte jodiskriminuese.
 - Sa më sipër, e drejta e çdo përdoruesi të rrjetit për akses në rrjetin e shpërndarjes apo të transmetimit është e garantuar me ligj.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “SMART WATT” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me fuqi të instaluar 2 MW, në zonën Sheq Marinas, njësia administrative Topojë, Bashkia Fier për një afat 25 vjeçar.
2. Para vënies në punë të centralit, shoqëria “SMART WATT” sh.p.k, të depozitojë në ERE miratimin e pikës së lidhjes me rrjetin e transmetimit apo shpërndarjes.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim, mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike dhe mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI